



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

NJËSIA E HARTIMIT TË DOKUMENTAVE TË TENDERIT

Nr. _____ prot.

Himarë , më _____.____.2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “NDËRTIMI I DY PARKIMEVE PUBLIKE NË FSHATIN
KUDHËS”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punime
ndërtimi për parking 45223300-9**

VLERA E FONDIT: 8 332 274 (tetë milionë e treqind e tridhjetë e dy mijë e dyqind e shtatëdhjetë
e katër) **Lekë pa TVSH**

Përlllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike është kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, Inxhinieri është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.1.1 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga organet kompetente, e cila duhet të përfshijë kategoritë e mëposhtme:*

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

- NP-1 A – Punime gjurmimi në tokë;
- NP-4 A – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale;

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- NS-18 A – Punime topogjeodezike.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që, në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit, merr përsipër të realizojë.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (ose ministrisë kompetente të kohës) në Republikën e Shqipërisë, referuar VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, nenin 39, pika 6, gërma (a), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se

”6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”, Ligjin Nr. 8402 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998 të ndryshuar, VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar.

Në bazë të licencës profesionale të shoqërisë tregohet aftësia teknike e profesionale e realizimit të kontratës që prokurohet dhe pikat e kërkuara të licensës janë përcaktuar nga vlera e punimeve që do të realizohen si dhe nisur nga natyra e punëve që do të kryhen sipas zërave të preventivit. Nisur nga fakti që vlera e objektit është më e vogël se 20 milion lekë për kategoritë e punimeve, është zgjedhur niveli i klasifikimit ”A” që i përgjigjet kësaj vlere.

Bazuar në natyrën e punimeve të parashikuara në preventiv, rezulton se licencat e kërkuara janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin dhe volumet e punimeve që do të realizohen.

Kategoria NP-1 A – Punime gjurmimi në tokë. Kjo kategori licence justifikohet nga fakti se objekti përfshin punime të konsiderueshme të gjurmimit të dheut dhe përgatitjes së trupit të rrugës apo të infrastrukturës mbështetëse. Punimet e gjurmimit janë proces bazë për realizimin e shtresave të mëvonshme konstruktive, si shtresa e çakëllit, shtresa stabilizante dhe shtresat e konglomeratit dhe betonit.

Kategoria NP-4 A – Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale është e argumentuar dhe në përputhje me objektin e prokurimit, pasi punimet e parashikuara në preventiv lidhen drejtpërdrejt me ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe të sipërfaqeve të parkimit. Preventivi përfshin punime gjurmimi, transport dheu, mbushje me çakëll e gur gurore në trupin e rrugës, shtresa zhavori dhe stabilizanti, punime betoni, ndërtim tombinosh, sinjalistikë horizontale si dhe vendosje parmakësh metalikë. Këto punime përbëjnë elementë tipikë të ndërtimit të rrugëve dhe parkimeve publike, ndërsa shtresat rrugore, sistemet e drenazhimit, sinjalistika dhe elementët e sigorisë rrugore përfshihen në fushën e zbatimit të kategorisë NP-4. Për këtë arsye, kërkesa për disponimin e kësaj licence konsiderohet në përputhje me natyrën dhe përmasat e punimeve objekt prokurimi.

Kërkesa për kategorinë NS-18 A – Punime topogjeodezike justifikohet duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit dhe nevojën për zbatim të saktë të projektit në terren. Punimet e parashikuara përfshijnë gjurmime, shtresa rrugore, ndërtim tombinosh, punime betoni, sinjalistikë horizontale dhe elementë të sigorisë rrugore, të cilat kërkojnë piketim, vendosje kuotash, kontroll të akseve dhe verifikim të niveleve gjatë fazës së zbatimit.

Punimet topogjeodezike janë të nevojshme për përcaktimin e saktë të pozicionit të parkimeve, vendosjen e akseve të punimeve, kontrollin e kuotave të gjurmimeve dhe mbushjeve, verifikimin e pjerrësive dhe niveleve të shtresave rrugore, si dhe për pozicionimin e saktë të tombinove, sinjalistikës dhe elementëve të tjerë të projektit. Këto procese ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe përputhshmërinë e punimeve me projektin e miratuar. Për rrjedhojë, kërkesa për kategorinë NS-18 A synon të garantojë që operatori ekonomik disponon kapacitetin profesional dhe teknik për kryerjen e punimeve topogjeodezike të nevojshme gjatë zbatimit të objektit, duke siguruar realizimin korrekt të punimeve sipas koordinatave, kuotave dhe parametrave të projektit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës...”; nenin 43 pika 2/c dhe pika 3, nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohen se:

“2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme”.

“3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor”.

“Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”.

Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.*

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron është vendosur konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për:

- një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 29 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së kryer, e shoqëruar me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore si dhe me situacionet e punimeve dhe akt-kolaudimin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se *”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ku parashikohet se *”Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: a) Për kontratat e punëve:*

i. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 30 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit,

nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ii. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se vlera limit e kontratës ose lotit që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Referuar nenit 55 pika 4 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar është përcaktuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 29 % të vlerës së fondit limit, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat e sistemeve të menaxhimit, të vlefshme në datën e hapjes së procedurës së prokurimit, si më poshtë:

a) Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015 (ose ekuivalente), që vërteton zbatimin e standardeve të menaxhimit të cilësisë;

b) Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor ISO 14001:2015 (ose ekuivalente), që vërteton zbatimin e standardeve të menaxhimit mjedisor;

c) Certifikatë të Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor ISO 39001:2012 (ose ekuivalente);

Operatorët ekonomikë mund të paraqesin certifikata ekuivalente ose dokumente të tjera të barasvlershme, të cilat provojnë përmbushjen e standardeve të kërkuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Certifikatat duhet të jenë lëshuar nga organe të vlerësimit të konformitetit të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizma akreditues ndërkombëtarë të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë certifikatat përkatëse vetëm për pjesën e punimeve ose shërbimeve që merr përsipër të realizojë, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale”

“1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”, nenin 44, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të

paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lid, janë kërkuar këto certifikata me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të mjedisit”.

ISO 9001:2015 – Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë

Kërkesa për certifikatën ISO 9001:2015 është proporcionale me objektin e prokurimit, pasi punimet e parashikuara përfshijnë gërmime, shtresa rrugore, punime betoni, kanalizime, sinjalistikë dhe elementë sigurie rrugore. Zbatimi i një sistemi të menaxhimit të cilësisë garanton organizimin dhe kontrollin e proceseve të punës, monitorimin e cilësisë së materialeve dhe realizimin e punimeve në përputhje me specifikimet teknike dhe projektin e miratuar. Kjo certifikatë siguron që operatori ekonomik disponon procedura të dokumentuara për kontrollin e cilësisë dhe menaxhimin e proceseve të zbatimit të kontratës.

ISO 14001:2015 – Sistemi i Menaxhimit Mjedisor

Kërkesa për certifikatën ISO 14001:2015 është e justifikuar duke pasur parasysh se objekti përfshin gërmime dheu, transport materiale, mbushje me materiale inerte, përdorim të makinerive të ndërtimit dhe punime të tjera që mund të ndikojnë në mjedis. Zbatimi i një sistemi të menaxhimit mjedisor garanton identifikimin dhe kontrollin e ndikimeve mjedisore që lidhen me aktivitetin ndërtimor, menaxhimin e mbetjeve, kontrollin e pluhurave dhe ndotjes, si dhe respektimin e kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Për rrjedhojë, kjo certifikatë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve që do të realizohen.

ISO 39001:2012 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë në Trafikun Rrugor

Kërkesa për certifikatën ISO 39001:2012 është e argumentuar pasi objekti lidhet me ndërtimin e dy parkimeve publike, të cilat përbëjnë pjesë të infrastrukturës së qarkullimit rrugor. Punimet përfshijnë realizimin e shtresave rrugore, sinjalistikës horizontale, elementëve të sigurisë dhe organizimin e qarkullimit brenda zonës së parkimit. Zbatimi i një sistemi të menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor kontribuon në minimizimin e rreziqeve që lidhen me lëvizjen e mjeteve dhe përdoruesve të rrugës gjatë dhe pas përfundimit të punimeve, si dhe garanton që operatori ekonomik zbaton praktika dhe procedura që lidhen me sigurinë rrugore. Duke qenë se objekti përfundimtar do të shërbejë për qarkullimin dhe parkimin e automjeteve, kërkesa për këtë standard konsiderohet e lidhur me natyrën e kontratës dhe me qëllimin e saj.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë fuqi punëtore, për muajin e fundit, prej minimalisht 14 (katëmbëdhjetë) personash.

Kriteri do të vërtetohet me:

a) vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore;

b) listëpagesa e punonjësve, të konfirmuar nga autoritetet përkatëse, të shoqëruara me formularët e deklaratimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit. Për dokumentacionin provues zbatohen përcaktimet e nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se ”4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”.

Kriteri lidhet drejtpërdrejt me natyrën, volumet dhe organizimin e punimeve të parashikuara në specifikimet teknike.

Ky numër përfaqëson minimumin e nevojshëm për të garantuar që punimet të zhvillohen paralelisht, me cilësi dhe në përputhje me kërkesat për siguri, mjedis dhe afate. Një numër më i ulët do të detyronte operatorin të kryente proceset në mënyrë të fragmentuar, duke rritur rrezikun e vonesave, uljes së cilësisë dhe mosrespektimit të kushteve teknike të kontratës.

Kërkesa për disponimin e një fuqie punëtore minimale prej 14 (katërmëdhjetë) punonjësish është përcaktuar në përputhje me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e punimeve objekt kontrate, si dhe me nevojën për realizimin e tyre brenda afateve të përcaktuara. Numri i kërkuar i punonjësve është vlerësuar duke marrë në konsideratë zërat konkretë të preventivit dhe nevojën për zhvillimin paralel të proceseve të punës në kantier.

Objekti i prokurimit përfshin punime gërmimi dhe transporti të dheut, realizimin e shtresave rrugore, punime betoni e betonarmeje, punime hekuri, ndërtimin e tombinove, vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe montimin e parmakëve metalikë. Këto procese pune kërkojnë angazhimin e personelit të mjaftueshëm teknik dhe punëtor për të garantuar cilësinë dhe respektimin e afateve të kontratës.

Për punimet e gërmimit me ekskavator zingjir në kanale me gjerësi mbi 2 m është i nevojshëm minimalisht një operator ekskavatori, si dhe një punëtor ndihmës për kontrollin e niveleve, drejtimin e punimeve dhe sigurimin e kantierit. Për transportin e materialeve dhe të dheut deri në 10 km nevojitet minimalisht një drejtues automjeti.

Për realizimin e shtresave rrugore, të cilat përfshijnë mbushjen me çakëll e gur gurore, shtresën e zhavorit dhe shtresën stabilizante, është i nevojshëm një grup minimal prej tre punonjësish, të përbërë nga operatori i makinerisë së ngjeshjes dhe dy punëtorë për shpërndarjen, sistemimin dhe kontrollin e materialeve.

Punimet e betonit dhe betonarmeve, të cilat përfshijnë strukturat monolite C12/15, strukturat e holla C20/25 dhe strukturat C25/30, kërkojnë një ekip minimal prej tre punonjësish, të përbërë nga punëtorë betoni dhe ndihmës për përgatitjen, hedhjen, vibrimin dhe përfundimin e betonit.

Për punimet e hekurit të betonit, të cilat përfshijnë hekurin Ø6–10 mm dhe Ø mbi 12 mm, kërkohen minimalisht dy punonjës të specializuar për prerjen, përkuljen, lidhjen dhe montimin e armaturës. Ndërtimi i tombinove me tuba betoni Ø600 mbi shtresë betoni kërkon minimalisht një punëtor të specializuar për vendosjen e elementëve dhe realizimin e punimeve ndihmëse të kanalizimit.

Për realizimin e sinjalistikës horizontale me bojë bikomponente nevojitet minimalisht një punonjës për aplikimin e vijëzimit dhe kontrollin e parametrave teknikë të tij.

Montimi i parmakëve metalikë kërkon minimalisht një punonjës për vendosjen, fiksimin dhe kontrollin e elementëve metalikë.

Përveç punonjësve të angazhuar drejtpërdrejt në proceset e mësipërme, është i nevojshëm edhe një drejtues teknik ose përgjegjës kantieri, i cili koordinon aktivitetet në terren, ndjek zbatimin e projektit, kontrollon cilësinë e punimeve dhe garanton respektimin e kërkesave teknike dhe të sigurisë.

Në përmbledhje, nevoja minimale për fuqi punëtore paraqitet si më poshtë:

- 1 drejtues teknik i punimeve;
- 1 operator ekskavatori;
- 1 punëtor ndihmës për punimet e gërmimit;
- 1 drejtues automjeti transporti;
- 3 punonjës për punimet e shtresave rrugore;
- 3 punonjës për punimet e betonit;
- 2 punonjës për punimet e hekurit;
- 1 punonjës për punimet e tombinove dhe kanalizimeve;
- 1 punonjës për sinjalistikën horizontale;
- 1 punonjës për montimin e parmakëve metalikë.

Në total rezulton një nevojë minimale prej 14 punonjësish.

Ky numër është vlerësuar si minimumi i domosdoshëm për të garantuar realizimin e njëkohshëm të proceseve kryesore të punës, për të shmangur ndërprerjet në zbatim dhe për të siguruar përfundimin e kontratës brenda afateve të parashikuara. Për rrjedhojë, kërkesa për një fuqi punëtore minimale prej 14 punonjësish konsiderohet proporcionale me objektin e kontratës, vëllimin e punimeve dhe kompleksitetin teknik të tyre.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë personelin kryesor drejtues teknik, të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe që figuron në listëpagesat e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier ndërtimi;
- 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet;

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, kontratë pune, CV dhe librezë pune.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nëpërmjet formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Në zbatim të pikave 1 dhe 6 të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimeve të nenit 82 të LPP-së.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, të renditur i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të

vetëdeklaruar, si dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të ofertës të paraqitura në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Kërkesa për disponimin e personelit kryesor drejtues teknik është përcaktuar në funksion të natyrës, kompleksitetit dhe karakteristikave teknike të punimeve objekt kontrate, me qëllim garantimin e zbatimit të tyre në përputhje me projektin, specifikimet teknike dhe standardet e cilësisë. Kërkesa për një inxhinier ndërtimi konsiderohet e domosdoshme duke qenë se objekti i prokurimit përfshin një gamë të gjerë punimesh ndërtimore dhe infrastrukturore, të cilat kërkojnë drejtim teknik dhe mbikëqyrje profesionale gjatë gjithë periudhës së zbatimit. Preventivi përfshin punime gërmimi, realizim shtresash rrugore, punime betoni dhe betonarmeje, vendosje armature, ndërtim tombinosh, sinjalistikë horizontale dhe montim të elementëve metalikë.

Inxhinieri i ndërtimit është përgjegjës për organizimin e punimeve në kantier, kontrollin e zbatimit të projektit, verifikimin e cilësisë së materialeve, kontrollin e proceseve të betonimit, realizimin e shtresave rrugore, ndjekjen e punimeve të kanalizimeve dhe strukturave të betonit, si dhe për respektimin e kushteve teknike të zbatimit dhe të sigurisë në punë.

Gjithashtu, ky specialist garanton koordinimin ndërmjet proceseve të ndryshme të punës, kontrollin e volumeve të realizuara dhe përputhshmërinë e punimeve me dokumentacionin teknik të objektit.

Kërkesa për një inxhinier ndërtimi është plotësisht e lidhur me natyrën dhe kompleksitetin e punimeve objekt kontrate.

Kërkesa për një inxhinier topograf/gjeodet lidhet me nevojën për realizimin e saktë të punimeve në terren dhe zbatimin korrekt të projektit. Punimet e parashikuara përfshijnë gërmime, shtresa rrugore, tombino, elementë të kanalizimeve dhe punime infrastrukturore që kërkojnë përcaktimin e akseve, kuotave dhe niveleve të projektit.

Inxhinieri topograf/gjeodet është përgjegjës për piketimin e objektit në terren, përcaktimin e koordinatave dhe kuotave të projektit, kontrollin e niveleve të gërmimeve dhe mbushjeve, verifikimin e pjerrësive të shtresave rrugore, si dhe kontrollin e pozicionimit të elementëve të ndryshëm të infrastrukturës.

Ky specialist siguron që punimet të realizohen sipas koordinatave dhe dimensioneve të projektit, duke shmangur devijimet gjatë zbatimit dhe duke garantuar saktësinë gjeometrike të objektit. Për shkak të karakterit infrastrukturor të punimeve dhe nevojës për kontroll të vazhdueshëm të kuotave dhe akseve, prania e një inxhinieri topograf/gjeodet konsiderohet e nevojshme dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Kërkesa për disponimin e një inxhinieri ndërtimi dhe një inxhinieri topograf/gjeodet është në përputhje me natyrën e punimeve, vëllimin e tyre dhe nevojën për drejtëm teknik e kontroll profesional gjatë zbatimit të kontratës, duke garantuar realizimin e punimeve sipas projektit, specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë personelin teknik dhe punonjësit e nevojshëm për realizimin e kontratës, të cilët duhet të jenë të kualifikuar sipas profileve përkatëse dhe të rezultojnë të punësuar pranë operatorit ekonomik, sipas legjislacionit në fuqi.

Për realizimin e punimeve objekt prokurimi, operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht personelin e mëposhtëm:

- 2 (dy) betonues;
- 1 (një) hekurkthyes;
- 1 (një) karpentier;
- 1 (një) murator;
- 1 (një) teknik ndërtimi;
- 1 (një) eskavatorist;
- 1 (një) automakinist;
- 2 (dy) shoferë.

Disponimi i personelit të mësipërm deklarohet nga operatori ekonomik në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në përputhje me nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Operatori ekonomik i renditur i pari paraqet dokumentacionin provues, si më poshtë:

a) Kontratat individuale të punës, të vlefshme sipas legjislacionit në fuqi;

b) Listëpagesat e sigurimeve shoqërore (E-Sig), për muajin e fundit përpara datës së hapjes së ofertave, ku të rezultojë punësimi i personelit të kërkuar;

c) Për operatorët e mjeteve (eskavatoristë, automakinistë dhe shoferë), Dëshmi të Aftësisë Profesionale ose leje drejtimi të kategorisë përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

Për operatorët e mjeteve të rënda (eskavatoristë dhe automakinistë), dëshmitë e aftësisë profesionale duhet të jenë të vlefshme dhe të lëshuara në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit.

Në rast se mjetet e kërkuara janë marrë me qira nga persona fizikë ose juridikë dhe shoqërohen me operatorët përkatës, eskavatoristët, automakinistët dhe shoferët që vihen në dispozicion së bashku me mjetet nuk është e nevojshme të figurojnë në listëpagesat e operatorit ekonomik ofertues. Në këtë rast, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që provon disponimin e mjetit dhe të operatorit të tij, sipas marrëveshjes së qirasë ose kontratës përkatëse. Në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit operatori ekonomik deklaron për operatorët e mjeteve: emrin dhe mbiemrin, profilin e punës, datën e kontratës së punës ose të marrëveshjes përkatëse, numrin e dëshmisë së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmërisë së saj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se „6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit” si dhe VKM Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, Urdhërin Nr. 109, datë 05.08.2013 ”Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, pasi për kryerjen e punimeve të veçanta sipas zërave të preventivit kërkohen specialistët e sipërpërmendur.

Qëllimi i vendosjes së këtij kriteri shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas specifikimeve teknike si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve, volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të përcaktuara në specifikimet teknike.

Kërkesa për disponimin e personelit teknik dhe të punonjësve të specializuar është përcaktuar në funksion të natyrës, vëllimit dhe kompleksitetit të punimeve objekt kontrate, me qëllim garantimin e realizimit të tyre sipas projektit, specifikimeve teknike dhe afateve të përcaktuara në dokumentet

e tenderit. Numri dhe profilet e kërkuara janë vlerësuar duke analizuar proceset konkrete të punës të parashikuara në preventiv dhe nevojën për zhvillimin paralel të aktiviteteve në kantiër.

2 (dy) betonues

Kërkesa për dy betonues lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit që parashikojnë realizimin e strukturave monolite të betonit C 12/15, strukturave të holla monolite C 20/25 dhe strukturave monolite C 25/30. Këto punime përfshijnë përgatitjen e sipërfaqeve, vendosjen e betonit, vibrimin, nivelimin dhe përfundimin e elementëve betonarme.

Procesi i betonimit kërkon vazhdimësi dhe koordinim të punës për të shmangur ndërprerjet gjatë hedhjes së betonit, të cilat mund të ndikojnë në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e strukturës. Për këtë arsye, prania e dy betonuesve konsiderohet minimumi i nevojshëm për realizimin e punimeve të betonit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit.

1 (një) hekurkthyes

Preventivi përfshin punime të hekurit të betonit me diametra Ø6–10 mm dhe Ø mbi 12 mm. Këto punime kërkojnë prerjen, përkuljen, lidhjen dhe montimin e armaturës sipas detajeve të projektit. Hekurkthyesi është punonjësi i specializuar që realizon përgatitjen e armaturës së nevojshme për strukturat e betonarmeve, tombinot dhe elementët e tjerë konstruktivë. Prania e këtij specialisti është e domosdoshme për të garantuar zbatimin korrekt të projektit dhe cilësinë e strukturave të betonit.

1 (një) karpentier

Punimet e betonit dhe betonarmeve kërkojnë ndërtimin e kallëpeve dhe formave mbajtëse për hedhjen e betonit. Karpentieri realizon përgatitjen, montimin dhe çmontimin e kallëpeve, duke siguruar që dimensionet, format dhe pozicionet e elementëve të betonit të jenë në përputhje me projektin.

Në mungesë të këtij specialisti nuk mund të realizohen në mënyrë korrekte punimet e strukturave monolite të betonit dhe elementëve të tjerë konstruktivë të objektit.

1 (një) murator

Punimet e objektit përfshijnë elementë të ndryshëm ndërtimorë dhe punime ndihmëse që kërkojnë ndërhyrjen e muratorit. Ky specialist është i nevojshëm për realizimin e sistemimeve të ndryshme, përfundimeve të punimeve të betonit, rregullimeve të elementëve të kanalizimit, mbushjeve lokale dhe punimeve ndihmëse që lidhen me ndërtimin e tombinove dhe elementëve të tjerë të objektit. Prania e muratorit garanton përfundimin e punimeve sipas kërkesave teknike dhe standardeve të zbatimit.

1 (një) teknik ndërtimi

Tekniku i ndërtimit është personeli që ndjek në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve në kantiër. Ai kontrollon dimensionet, kuotat, volumeve e punimeve, organizimin e punëtorëve dhe zbatimin e grafikut të punimeve.

Gjithashtu, tekniku ndihmon drejtuesin teknik në evidentimin e punimeve të realizuara, kontrollin e materialeve dhe koordinimin e proceseve të ndryshme të punës. Për shkak të natyrës së objektit dhe numrit të proceseve që zhvillohen paralelisht, prania e tij konsiderohet e domosdoshme.

1 (një) eskavatorist

Punimet e gërmimit me ekskavator zingjir në kanale me gjerësi mbi 2 m përbëjnë një nga proceset kryesore të zbatimit të objektit. Operimi i ekskavatorit kërkon personel të specializuar dhe të pajisur me dëshmi të vlefshme të aftësisë profesionale.

Eskavatoristi është përgjegjës për realizimin e gërmimeve sipas kuotave dhe dimensioneve të projektit, si dhe për sigurinë e punimeve gjatë operimit të makinerive të rënda.

1 (një) automakinist

Punimet e shtresave rrugore përfshijnë mbushjen me çakëll, shtresat e zhavorit dhe shtresat stabilizante, të cilat realizohen me makineri të specializuara për përhapjen dhe ngjeshjen e materialeve.

Automakinisti operon makineritë e ndërtimit të nevojshme për realizimin e këtyre proceseve dhe garanton ekzekutimin korrekt të shtresave rrugore sipas parametrave teknikë të projektit.

2 (dy) shoferë

Preventivi parashikon transportin e dheut dhe të materialeve të ndërtimit deri në 10 km, si dhe furnizimin e vazhdueshëm të kantierit me materiale inerte dhe materiale ndërtimi.

Disponimi i dy shoferëve është vlerësuar i nevojshëm për të garantuar vazhdimësinë e transportit të materialeve dhe zhvillimin paralel të punimeve në kantier. Prania e dy drejtuesve mjeteve shmanë ndërprerjet e proceseve të punës dhe siguron furnizimin e vazhdueshëm të objektit.

Në përmbledhje, personeli i kërkuar përbën minimumin e nevojshëm teknik dhe profesional për realizimin e kontratës:

- a) 2 betonues për punimet e betonit dhe betonarmeve;
- b) 1 hekurkthyes për përgatitjen dhe montimin e armaturës;
- c) 1 karpentier për realizimin e kallëpeve;
- d) 1 murator për punimet ndihmëse ndërtimore;
- e) 1 teknik ndërtimi për ndjekjen dhe kontrollin e punimeve;
- f) 1 eskavatorist për punimet e gërmimit;
- g) 1 automakinist për makineritë e shtresave rrugore;
- h) 2 shoferë për transportin e materialeve.

Kërkesa për këto profile profesionale është në raport të drejtë me natyrën dhe vëllimin e punimeve të preventivit dhe synon të garantojë që operatori ekonomik disponon kapacitetin minimal njerëzor të nevojshëm për realizimin cilësor dhe në kohë të kontratës.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet, makineritë dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës, të cilat mund të jenë në pronësi ose të marra me qira, si më poshtë:

<i>Nr. Lloji i mjetit/makinerisë</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1 Kamionçinë me kapacitet deri në 3.5 ton	Pronësi ose me qira	1 copë
2 Kamion vetëshkarkues me kapacitet 10–20 ton	Pronësi ose me qira	1 copë
3 Kamion me vinç	Pronësi ose me qira	1 copë
4 Ekskavator me zinxhir me çekiq	Pronësi ose me qira	1 copë
5 Ekskavator me goma	Pronësi ose me qira	1 copë
6 Minieskavator	Pronësi ose me qira	1 copë
7 Fadromë	Pronësi ose me qira	1 copë
8 Betoniere	Pronësi ose me qira	2 copë
9 Vibrator thellësie	Pronësi ose me qira	2 copë
10 Vibrator i jashtëm	Pronësi ose me qira	2 copë

11 Matrapik

Pronësi ose me qira 2 copë

12 Autobot uji

Pronësi ose me qira 1 copë

Operatori ekonomik duhet të disponojë gjithashtu burime furnizimi për materialet inerte (çakëll, zhavorr, gur gurore apo materiale të ngjashme), nëpërmjet pronësisë, qirasë ose kontratave të furnizimit me subjekte të licencuara sipas legjislacionit në fuqi.

Subjektet furnizuese duhet të disponojnë lejet dhe autorizimet mjedisore të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi.

Disponimi i mjeteve, makinerive dhe pajisjeve deklarohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas përcaktimeve të nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Operatori ekonomik i renditur i pari paraqet dokumentacionin provues si më poshtë:

a) Për mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë:

- Lejen e qarkullimit;
- Certifikatën e kontrollit teknik, kur kërkohet nga legjislacioni;
- Policën e sigurimit të vlefshme;
- Dokumentacionin për pagesën e detyrimeve përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

b) Për mjetet e marra me qira:

- Kontratën e qirasë ose marrëveshjen e disponimit;
- Dokumentacionin e pronësisë së mjetit;
- Dokumentacionin ligjor të mjetit sipas shkronjës "a".

c) Për makineritë dhe pajisjet që nuk regjistrohen në regjistra publikë:

- Dokumentacionin që vërteton pronësinë ose disponimin e tyre.

Gjithashtu, në zbatim të legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë, operatori ekonomik duhet të disponojë pajisjet minimale të mbrojtjes dhe sigurisë në punë, si më poshtë:

- Kuti të ndihmës së shpejtë – 5 copë;
- Tabela sinjalistike të përkohshme – 10 copë;
- Helmeta mbrojtëse – 5 copë;
- Jelekë fosforeshentë – 5 copë;
- Fikëse zjarri të lëvizshme – 4 copë.

Këto pajisje deklarohen në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacioni provues paraqitet nga operatori ekonomik i renditur i pari.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, ku parashikohet se "4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti

kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë, operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Lloji dhe numri i mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës është përcaktuar duke u bazuar në zërat e preventivit dhe specifikimeve teknike. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të preventivit. Përcaktimi i paisjeve dhe makinerive është bërë duke marrë në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre” (ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018), si dhe hapësirat fizike rreth objektit, mundësive të manovrimit me mjete të rënda, urbanizimit për efekt të zhurmave dhe ndotjes etj.

Kërkesa për disponimin e mjeteve, makinerive dhe pajisjeve është përcaktuar në funksion të natyrës, vëllimit dhe kompleksitetit të punimeve objekt kontrate, me qëllim garantimin e realizimit të tyre sipas specifikimeve teknike, projektit dhe afateve të zbatimit. Mjetet dhe makineritë e kërkuara përfaqësojnë kapacitetin minimal teknik të nevojshëm për realizimin e punimeve të parashikuara në preventiv, i cili përfshin punime gjurmimi, transporti të materialeve, shtresa rrugore, punime betoni dhe betonarmeje, punime hekuri, ndërtim tombinosh, sinjalistikë horizontale dhe vendosje të parmakëve metalikë.

Kamionçina me kapacitet deri në 3.5ton është e nevojshme për transportin e materialeve të lehta të ndërtimit, veglave të punës, pajisjeve ndihmëse, materialeve të sinjalistikës dhe elementëve të ndryshëm që përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Ky mjet mundëson furnizimin e vazhdueshëm të kantierit dhe transportin e pajisjeve në zona të ndryshme të objektit.

Kamioni vetëshkarkues me kapacitet 10–20 ton lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit që parashikojnë transportin e dheut dhe materialeve të ndërtimit deri në 10 km, si dhe furnizimin me çakëll, zhavorr dhe materiale të tjera inerte të nevojshme për realizimin e shtresave rrugore. Ky mjet është i domosdoshëm për transportin dhe shkarkimin e materialeve në kantier.

Kamioni me vinç është i nevojshëm për transportin, ngritjen dhe vendosjen e elementëve të rëndë të ndërtimit, si tubat e betonit të tombinove dhe elementët metalikë të parmakëve. Përdorimi i këtij mjeti siguron realizimin e këtyre proceseve në kushte sigurie dhe me efikasitet teknik.

Ekskavatori me zinxhir i pajisur me çekiç është kërkuar duke marrë në konsideratë punimet e gjurmimit në kanale me gjerësi mbi 2 m dhe në terrene të kategorisë IV. Pajisja me çekiç hidraulik mundëson ndërhyrjen në rastet e pranisë së formacioneve të forta ose pengesave gjatë gjurmimeve. Ky mjet përbën një nga makineritë kryesore për realizimin e punimeve të gjurmimit dhe përgatitjes së terrenit.

Ekskavatori me goma është i nevojshëm për realizimin e gjurmimeve ndihmëse, sistemimin e terrenit dhe ngarkimin e materialeve në zona të ndryshme të kantierit. Lëvizshmëria e tij e lartë mundëson kryerjen e proceseve të ndryshme të punës në mënyrë të shpejtë dhe efikase.

Minieskavatori është i domosdoshëm për punime në hapësira të kufizuara, pranë elementëve ekzistues ose në zona ku përdorimi i makinerive të mëdha është i vështirë. Ky mjet shërben për gërmime të lokalizuara dhe punime ndihmëse gjatë realizimit të kanalizimeve dhe tombinove.

Fadroma është e nevojshme për ngarkimin, transportin e shkurtër, shpërndarjen dhe sistemimin e materialeve inerte. Ajo përdoret gjatë realizimit të shtresave rrugore, mbushjeve me çakëll dhe shpërndarjes së materialeve të ndryshme në kantier.

Kërkesa për dy betoniere lidhet me punimet e shumta të betonit të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë strukturat monolite C12/15, strukturat e holla C20/25 dhe strukturat C25/30. Disponimi i dy pajisjeve garanton vazhdimësinë e punimeve të betonimit dhe shmang ndërprerjet gjatë procesit të realizimit të betonit.

Dy vibratorët e thellësisë janë të nevojshëm për kompaktimin e betonit dhe eliminimin e boshllëqeve gjatë betonimit të elementëve strukturorë. Përdorimi i tyre ndikon drejtpërdrejt në cilësinë, qëndrueshmërinë dhe rezistencën e strukturave të betonit.

Dy vibratorët e jashtëm kërkohen për realizimin e elementëve të hollë të betonit dhe kallëpeve ku përdorimi i vibratorëve të brendshëm nuk është i mundur. Këto pajisje kontribuojnë në arritjen e cilësisë së kërkuar të elementëve betonarme.

Dy matrapikët janë të nevojshëm për punime prishjeje, pastrimi, hapje vrimash dhe ndërhyrje të ndryshme gjatë procesit të zbatimit të punimeve. Këto pajisje përdoren në punime ndihmëse dhe në raste të nevojshme gjatë realizimit të objektit.

Autoboti i ujit është i domosdoshëm për lagjen e shtresave rrugore gjatë procesit të ngjeshjes, për kontrollin e pluhurit në kantier dhe për mirëmbajtjen e betonit pas hedhjes së tij. Përdorimi i këtij mjeti ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e shtresave rrugore dhe të punimeve të betonit.

Kërkesa për disponimin e burimeve të furnizimit me materiale inerte është vendosur për shkak se preventivi përfshin punime të konsiderueshme me çakëll, zhavorr dhe materiale gurore. Sigurimi i këtyre materialeve nëpërmjet pronësisë, qirasë ose kontratave të furnizimit me subjekte të licencuara garanton vazhdimësinë e punimeve, cilësinë e materialeve dhe përputhshmërinë me legjislacionin mjedisor.

Gjithashtu, pajisjet e sigurisë dhe mbrojtjes në punë janë kërkuar në zbatim të legjislacionit për sigurinë dhe shëndetin në punë. Kutitë e ndihmës së shpejtë, tabelat sinjalistike të përkohshme, helmetat mbrojtëse, jelekët fosforeshentë dhe fikëset e zjarrit janë të nevojshme për garantimin e sigurisë së punonjësve dhe organizimin e sigurt të kantierit.

Për rrjedhojë, kërkesa për disponimin e këtyre mjeteve, makinerive, pajisjeve dhe burimeve të furnizimit është në përpjesëtim me natyrën dhe vëllimin e punimeve të parashikuara në preventiv dhe përfaqëson minimumin e nevojshëm teknik për realizimin cilësor dhe në afat të kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të përcaktojë, nëpërmjet një deklarate të nënshkruar nga administratori i shoqërisë, Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën profesionale të shoqërisë. Në këtë deklaratë duhet të konfirmohet se Drejtuesi Teknik nuk është i angazhuar si drejtues teknik në kontrata të tjera gjatë periudhës së zbatimit të kësaj kontrate dhe se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës së realizimit të punimeve në objekt.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të verifikuar vërtetësinë e deklarimeve të paraqitura. Në rast të konstatimit të deklarimeve të rreme, do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet të përcaktojë, nëpërmjet deklaratës përkatëse, Drejtuesin Teknik për pjesën e punimeve që merr përsipër të realizojë, në përputhje me marrëveshjen e bashkëpunimit dhe përqindjen e pjesëmarrjes në zbatimin e kontratës. Drejtuesi Teknik duhet të jetë i përfshirë në licencën profesionale të operatorit ekonomik përkatës dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së zbatimit të punimeve që do të realizojë.

Disponimi i Drejtuesit Teknik do të deklarohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në përputhje me nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, operatori ekonomik i renditur i pari duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë:

- Kontratë pune të vlefshme;
- Diplomë universitare;
- Librezë pune ose dokument ekuivalent që provon eksperiencën profesionale;
- Curriculum Vitae (CV).

Kriteri do të konsiderohet i përmbushur në fazën e ofertimit nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues do të kërkohej vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.

Argumentimi: Kërkesa për përcaktimin e Drejtuesit Teknik të punimeve është vendosur në funksion të natyrës, vëllimit dhe kompleksitetit të punimeve objekt kontrate, me qëllim garantimin e drejtimit teknik, organizimit dhe mbikëqyrjes së vazhdueshme të punimeve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Objekti i prokurimit përfshin punime gërmimi, transporti të materialeve, realizim të shtresave rrugore, punime betoni dhe betonarmeje, punime të hekurit të betonit, ndërtim tombinosh, sinjalistikë horizontale dhe vendosje të parmakëve metalikë. Këto procese kërkojnë koordinim të vazhdueshëm teknik, kontroll të cilësisë së punimeve dhe monitorim të zbatimit të projektit në terren.

Drejtuesi Teknik është personi përgjegjës për organizimin e punimeve në kantier, kontrollin e zbatimit të projektit, koordinimin e personelit dhe makinerive, ndjekjen e afateve të punimeve, verifikimin e cilësisë së materialeve dhe respektimin e kushteve teknike të zbatimit. Ai garanton që punimet të realizohen sipas projektit, specifikimeve teknike dhe standardeve në fuqi.

Punimet e gërmimit në kanale me ekskavator, realizimi i shtresave rrugore, punimet e betonit dhe betonarmeve, vendosja e armaturës, ndërtimi i tombinove dhe punimet e sinjalistikës kërkojnë kontroll të vazhdueshëm teknik në terren, për shkak të proceseve të ndryshme që zhvillohen njëkohësisht gjatë zbatimit të kontratës.

Për këtë arsye është kërkuar që Drejtuesi Teknik të jetë i përfshirë në licencën profesionale të shoqërisë, duke garantuar se ai përbën pjesë të strukturës teknike të operatorit ekonomik dhe disponon kualifikimin e nevojshëm profesional për drejtimin e punimeve.

Kërkesa që Drejtuesi Teknik të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së zbatimit të punimeve lidhet me nevojën për praninë e tij të vazhdueshme në objekt dhe me sigurimin e një mbikëqyrjeje efektive të procesit të ndërtimit. Angazhimi i njëkohshëm në disa kontrata mund të ndikojë në ndjekjen e punimeve, respektimin e afateve dhe kontrollin e cilësisë së zbatimit.

Prania e Drejtuesit Teknik është e nevojshme për:

- a) organizimin e aktivitetit në kantier;
- b) koordinimin e personelit dhe makinerive;
- c) kontrollin e volumeve të punimeve;
- d) verifikimin e cilësisë së materialeve;
- e) zbatimin e projektit dhe specifikimeve teknike;
- f) respektimin e rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë;
- g) zgjidhjen e problematikave teknike që mund të shfaqen gjatë zbatimit.

Kërkesa për paraqitjen e kontratës së punës, diplomës, librezës së punës dhe CV-së synon të verifikojë kualifikimin profesional, përvojën dhe marrëdhënien e punës së Drejtuesit Teknik me operatorin ekonomik, duke garantuar disponueshmërinë reale të këtij personeli gjatë zbatimit të kontratës.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, përcaktimi i Drejtuesit Teknik nga secili anëtar për pjesën e punimeve që merr përsipër të realizojë garanton mbikëqyrjen teknike të të gjitha proceseve të punës dhe përgjegjësinë profesionale të secilit operator sipas përqindjes së pjesëmarrjes në kontratë.

Për rrjedhojë, kërkesa për disponimin e Drejtuesit Teknik të punimeve është në përpjesëtim me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e punimeve objekt kontrate dhe synon të garantojë drejtimin teknik, organizimin dhe kontrollin e vazhdueshëm të punimeve, duke siguruar realizimin cilësor dhe në afat të kontratës.

Specifikimet teknike, grafiku i ekzekutimit të punimeve, profilet e detajeve, vizatimet teknike, si dhe relacioni teknik janë hartuar nga projektuesi në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të projektimit dhe zbatimit të punimeve, si dhe me normat profesionale dhe teknike të fushës përkatëse. Këto dokumente pasqyrojnë në mënyrë të plotë, të detajuar dhe të argumentuar të gjitha elementet teknike, funksionale dhe ekonomike të nevojshme për realizimin korrekt dhe në përputhje me standardet e cilësisë të objektit të kontratës, duke garantuar zbatueshmërinë teknike, sigurinë, funksionalitetin dhe qëndrueshmërinë e investimit publik.

Dokumentacioni teknik është përgatitur në mënyrë të tillë që të mundësojë një kuptim të qartë dhe të njëjtë nga të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke shmangur paqartësitë, interpretimet subjektive apo kufizimet e pajustificuara të konkurrencës. Për këtë arsye, këto dokumente do t'i bashkëlidhen dokumentacionit të tenderit si pjesë përbërëse dhe thelbësore e tij, ndërsa preventivi është integruar si komponent i pandashëm i dokumentacionit teknik, duke paraqitur në mënyrë të strukturuar, analitike dhe të argumentuar vlerësimin ekonomik të punimeve, materialeve, makinerive dhe shërbimeve që do të realizohen në kuadër të kontratës. Specifikimet teknike paraqesin në mënyrë të qartë, të saktë dhe të detajuar minimumin e kërkesave teknike, funksionale dhe cilësore, si dhe tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse të objektit të prokurimit, të cilat garantojnë nivelin e kërkuar të cilësisë, sigurisë, funksionalitetit, jetëgjatësisë dhe qëndrueshmërisë së punimeve.

Nëpërmjet tyre sigurohet që çdo produkt, material, pajisje apo shërbim i propozuar nga operatorët ekonomikë të jetë i përshtatshëm për qëllimin e parashikuar, të përmbushë standardet teknike dhe ligjore në fuqi, si dhe të realizojë plotësisht funksionet për të cilat kërkohet. Hartimi i

specifikimeve teknike është bërë mbi baza objektive duke respektuar parimet themelore të konkurrencës së lirë, transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, me qëllim garantimin e përdorimit efektiv dhe eficient të fondeve publike.

Këto specifikime janë hartuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi për prokurimin publik, konkretisht me parashikimet e nenit 4, pika 38/b, ku përcaktohet kuptimi dhe përmbajtja e specifikimeve teknike, si dhe nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon detyrimin që specifikimet teknike të sigurojnë akses të barabartë për operatorët ekonomikë dhe të mos krijojnë pengesa të pajustificuara për konkurrencën në procedurat e prokurimit publik. Gjithashtu, hartimi i tyre është mbështetur edhe në nenin 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se specifikimet teknike duhet të formulohen në mënyrë të qartë, të plotë dhe funksionale, duke përshkruar kërkesat teknike dhe standardet që duhet të përmbushë objekti i prokurimit. Në të njëjtën kohë, dokumentacioni teknik është hartuar në respektim të parimeve të përcaktuara në nenin 2 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, përkatësisht parimit të transparencës, mosdiskriminimit, proporcionalitetit, barazisë në trajtim dhe garantimit të konkurrencës efektive ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Përmes këtij dokumentacioni teknik dhe ekonomik synohet krijimi i një baze të qartë, të unifikuar dhe të verifikueshme për përgatitjen dhe vlerësimin e ofertave, duke mundësuar krahasueshmëri reale ndërmjet tyre dhe duke garantuar që procedura e prokurimit të zhvillohet në mënyrë të drejtë, transparente dhe në përputhje me interesin publik. Gjithashtu, dokumentacioni siguron që realizimi i kontratës të kryhet sipas parametrave teknikë të kërkuar, brenda afateve të përcaktuara dhe me standardet e nevojshme të cilësisë, duke minimizuar risqet e mosrealizimit korrekt të punimeve apo të moskonformitetit me kërkesat kontraktore dhe ligjore në fuqi.

NJËSIA E PROKURIMIT